

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 171/2014**  
**“PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË KALIMIT TË TOKËS**  
**BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË**  
**PËRFITUESVE”, I NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË**  
**SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është zgjatja e afatit të përfundimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe thjeshtimi i procedurave të kryerjes së tij.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME**  
**PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME**  
**PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË**  
**TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe në mënyrë të veçantë për konsolidimin e të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore në territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME**  
**PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 171/2014 *“Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”*, të ndryshuar, ka për qëllim përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfituesve sipas ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, *“Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”*, të ndryshuar, të cilët nuk kanë bërë kalimin në pronësi, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Procesi i plotësimit të dokumentacionit të pronësisë mbi tokën bujqësore kryhet nga bashkitë. Për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës, ka ndarë tokën bujqësore, por nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi, ligji ngarkon Kryetarët e Bashkive, t’i plotësojnë ato, në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar, ndërsa Prefekti i Qarkut mbikqyr realizimin e këtij procesi.

Nga informacioni i mbledhur nga prefektët e qarqeve dhe bashkitë deri më datë 10 Tetor 2017 rezulton se janë paraqitur 2300 kërkesa nga familjet bujqësore.

Shumë bashki kanë proceduar me kërkesat e paraqitura, por nuk kanë finalizuar procesin deri në plotësimin e titujve të pronësisë, për shkak të disa problematikave të hasura.

Referuar nenit 2, pika 2, paragrafi “v”, Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), nuk mund të plotësohen për sipërfaqet e tokave bujqësore që janë *“objekt kërkesë, e cila po shqyrtohet nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por nuk është dhënë ende vendim”*. Përcaktimi i këtyre sipërfaqeve të tokave bujqësore është detyrim i Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP). Gjatë procesit të zbatimit të ligjit, bashkitë i janë drejtuar zyrtarisht kësaj Agjencie për të marrë informacionin respektiv. Ndërsa ATP, në përgjigjet zyrtare të saj konfirmon se është në kushtet e pamundësisë të japë një përgjigje përfundimtare dhe të saktë, sepse kërkesat e depozitura për njohje pronësie nuk janë të plotësuara me dokumentacionin hartografik sipas kërkesave ligjore, apo ekzistojnë mospërputhje ndërmjet dokumentacionit ligjor dhe atij hartografik të paraqitur.

Mungesa e këtij informacioni zyrtar nga ATP, e ka bllokuar vijimin dhe përfundimin e procesit nga bashkitë. Në këto kushte, në projektligjin e propozuar, parashikohet që kalimi i tokës bujqësore në pronësi të përfituesve (familjeve bujqësore) të moskushtëzohet me konfirmimin e faktit nëse kjo sipërfaqe toke është ose jo, objekt kërkesë që shqyrtohet nga ATP.

Një ndryshim i tillë nuk çënon të drejtën e subjekteve pretendues, që pas vendimit të ATP për njohjen e kësaj prone, të kompensohen sipas ligjit. Po kështu, ky ndryshim është në harmoni edhe me përcaktimet e nenit 25, të ligjit 133/2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës”*.

Në këto kushte, me qëllim që procesi i nisur nga bashkitë të konkretizohet me plotësimin e AMTP-ve, propozohet që afati i përfundimit të këtij procesi të jetë **data 31 korrik 2018**.

Ky afat është i mjaftueshëm për realizimin e gjithë procedurave të nevojshme që përcakton ligji.

Nëse ky afat nuk do të shtyhet, pra procesi nuk përfundon në rrugë administrative, përfituesit megjithëse kanë të drejtë t’i drejtohen organeve gjyqësore (kjo e drejtë është e parashikuar në ligj), procesi do të shtyhet edhe më tepër në kohë dhe do të shoqërohet edhe me kosto më të mëdha për përfituesit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Për këtë projektligj është përdorur si referencë neni 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

## **VI. PËRMbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit**

Nga sa u parashtrua në Kreun III, të këtij relacioni, në projektligjin e paraqitur propozohen të bëhen ndryshime në tre nenet e mëposhtëm:

Në nenin 2, pika 2, paragrafi “v”, sipas të cilit “v) është objekt kërkese, e cila po shqyrtohet nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por nuk është dhënë ende vendim“, shfuqizohet.

Për shkak të këtij ndryshimi, është e nevojshme të reflektohen edhe ndryshimet në pikën 2, të nenit 5, për të hequr referencat që lidhen me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ( sot Agjencia e Trajtimit të Pronave), si më poshtë:

Në nenin 5,

- pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nëse nga informacioni zyrtar i siguruar gjatë verifikimit të gjendjes juridike të pronës, rezulton se toka bujqësore është objekt shqyrtimi në gjykatë dhe ky institucion: ”

- në pikën 2, germa “a” dhe “b”, fjala “përcaktojnë”, zëvendësohet me fjalën “përcakton”.

- në pikën 2, germa “c”, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“nuk arrin të marrë vendim të formës së prerë, brenda afatit të plotësimit të AMTP-ve, sipas përcaktimit të nenit 6 të këtij ligji, atëherë vazhdon përdorimi i tokës nga përdoruesi, deri sa të ketë një vendim të formës së prerë nga gjykata ”

Ndërsa në nenin 6, pika 1, afati i plotësimit të AMTP-ve nga bashkitë nga 31 dhjetor 2017 ndryshohet në 31 korrik 2018.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Bashkitë, Këshillat e Qarqeve, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Drejtoritë e Bujqësisë, Komisioni Qeveritar i Tokës dhe Komisionet Vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe Prefektët e çdo Qarku.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Si pikënisje për hartimin e projektligjit ka qenë analiza që i është bërë rezultateve të punës së bashkive dhe problematikave të evidentuara prej tyre, gjatë realizimit të procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji i propozuar nuk mbart efekte financiare për buxhetin e shtetit, përsa i takon procesit të plotësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, për territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore, pasi kryhet nga administrata dhe me fondet e vetë bashkive.

**MINISTRI**

**NIKO PELESHI**

Konceptoi: Mimoza Shahini

Pranoi: Majlinda Bozgo

Miratoi: Irfan Tarelli

Shtjefen Zyla

Konfirmoi: Aurora Alimadhi